

KASEM BIÇOKU**PESHKOPATA E ARBNIT DHE KASTRIOTËT*****I**

Përcaktimi i shtrirjes krahinore (gjeografike) të Peshkopatës së Arbnit (*Episcopatus Arbanensis*) është çështje e rëndësishme si për historinë e organizimit kishtar, ashtu dhe për historinë politike të trojeve shqiptare gjatë shekujve të mesjetës. Sipas një dokumenti të fillimit të shek. XV Peshkopata e Arbnit shtrihej në zotërimet e Gjon Kastriotit¹. Peshkopë dhe abatë të Peshkopatës së Arbnit përmenden në dokumentet e kohës si misionarë të Gjon Kastriotit dhe, më pas, të Skënderbeut në vendet e tjera².

Organizimi administrativ i kishës dhe i shteteve mesjetare në trojet shqiptare është lidhur ngushtësisht me ndarjet krahinore. Këto të fundit nuk janë krijime rastësore, por janë krijime natyrore, ku rëndësi parësore

* Shënim: Për këtë artikull recensentët kanë dhënë vlerësime të ndryshme. Redaksia vendosi botimin e artikullit dhe krijimin e hapësirës për prononcimin e recensentëve.

¹ G. Valetini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV-XV*, (më tej: AAV), Tomus Quintus, München, f.21-22.

² *Illyrici Sacri tomus septimus. Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrachiensis, et Sirmiensis Auctore Daniele Farlato presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno*. Venetiis, MDCCCXVII. Apud Sebastianum Coleti. Superiorum permissu ac privilegio. *Tomus octavus*, Venetiis, MDCCCXIX, f.192b-204b (më tej: *Illyricum Sacrum*, 7); *Hierarchia Chatholica mediū aevi sive Summorum Pontificum, s. r. e. cardinalium, ecclesiarum antistitum series ab anno 1198 usque ad annum 1431 perducta e documentis tabularii praesertim Vaticani collecta, digesta, edita per Conradum Eubel, s. theol. doct. ord. min. conv. definitorem generalem olim apostolicum apud s. Petrum de Urbe poenitentiarum*. Editio Altera. Monasterii MDCCCXIII, vol. I, f.100, vol. II, f.92 (më tej: *Hierarchia Chatholica*); AAV, VIII, f. 442, XIII, f.82; Јован Радонић, *Ђурађ Кастриот Скендербег и Арбанија у XV веку*, Београд, 1942, nr. 146, f.15, 30, 89 (më tej: J. Радонић, *Ђурађ Кастриот*); Nicola Jorga, *Notes et extraits pour servir à l'histoire des croisades au XV siècle*, II, Paris, 1899, f.485, shën. 2 (më tej: N. Jorga, *Notes*); Oliver J. Schmitt, *Arbëria Venedike (1392-1479)*, Tiranë, 2007, f.301 (më tej: O.J. Schmitt, *Arbëria Venedike*); Luan Malltezi, *Një dokument i ri për Skënderbeun*, në: "Ekskluzive", Prishtinë, 2001, nr.20, f.61-64 (më tej: L. Malltezi, *Një dokument i ri*).

ka pasur mjedisi gjeografik, relievi. Ndarjet krahinore mesjetare, që pasqyrohen mirë te regjistrat kadastralë osmanë të shek. XV-XVI, ndihmojnë për të njohur shtrirjen gjeografike të peshkopatave mesjetare shqiptare. Peshkopatat mesjetare shtriheshin në një krahinë të rëndësishme ose në dy e më shumë krahina të vogla. Zakonisht peshkopatat mbajnë emrat e qyteteve, që ishin edhe qendra peshkopale. Ka edhe peshkopata me emra krahinash, sepse kanë munguar në to qendra të mirëfillta qytetare. Emërtimet e peshkopatave, që jepen kryesisht në dokumentet kishtarë, na ndihmojnë të njohim njëkohësisht edhe emrat mesjetarë të krahinave përkatëse.

Të dhënat e dokumenteve për peshkopatat shqiptare janë të pakta, ashtu si janë përgjithësisht edhe për historinë mesjetare shqiptare. Jeta politike e trazuar në këto troje gjatë shekujve të mesjetës, sidomos në gjysmën e dytë të shek. XIV e në vijim pas shembjes së Perandorisë Bizantine dhe të shtetit të Stefan Dushanit, ka ndikuar në organizimin e në veprimtarinë e kishës katolike.

Mungesa e klerikëve të lartë e të shkolluar mirë, sidomos e peshkopëve, ka qenë një dukuri e zakonshme në trojet shqiptare. Gjatë shekujve të mesjetës dhe gjatë periudhës osmane herë pas here kanë dalë klerikë të rangut më të ulët në krye të peshkopatave dhe madje ka pasur peshkopë që drejtonin më se një peshkopatë. “*Në qoftë se Arbënia nuk do të ketë ndonjë ndihmë më të madhe (prej Vatikanit - K. B.), në më pak se 7 vjet do të shkojë dëm i gjithë krishterimi i atjeshëm nga numri i pakët i peshkopëve dhe i meshtarëve që kanë pak dije*”, - ka shkruar më 1610 kryepeshkopi i Tivarit, Marin Bici³. Titulli i peshkopit, kur ky e ushtronte këtë detyrë në disa peshkopata, ka ndikuar që në burimet historike të dalin në disa raste me emrin e peshkopatës së tij manastire dhe kisha të një peshkopate tjetër. Prandaj janë krijuar edhe vështirësi për njohjen e saktë e në vijimësi të organizimit kishtar në trojet shqiptare.

Gjatë shekujve XVI-XVII, kur procesi i kalimit në besimin islam përfshiu në masë shqiptarët, strukturat e organizimit të kishës katolike pësuan ndryshime të rëndësishme në trojet shqiptare. Në fillim të viteve

³ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, (më tej: *Relacione*). Teksti origjinal dhe përkthimi përgatitur nga Injac Zamputi, vëllimi I (1610-1634), Tiranë, 1963, f.205; vëllimi II (1634-1650), Tiranë, 1965.

20 të shek. XVI Vatikani caktoi në këto treva 4 peshkopë: në Shkodër, Sapë, Lezhë dhe në Arbën⁴.

Disa prej ndarjeve administrative kishtare të periudhës osmane nuk përputheshin me ndarjet mesjetare, prandaj te burimet historike, sidomos tek autorët e relacioneve kishtare të shek. XVII⁵, ka paqartësi për shtrirjen e disa peshkopatave katolike. Ndër to janë Peshkopata e Arbnit dhe peshkopatat kufitare me të, sidomos Peshkopata e Shtjefnit (Stephaniacum), një nga më të vjetrat në Shqipëri⁶.

Studimi më i mirë për historikun e formimit dhe të shtrirjes gjeografike të Peshkopatës së Arbnit është bërë prej Aleksandër Meksit⁷. Shtrirjen gjeografike të Peshkopatës së Arbnit, A. Meksi e ka parë në kufijtë e rrethit të sotëm të Mirditës. Një punim për kryepeshkopatën e Durrësit është hartuar prej Frano Illias në vitet 60 të shek. XX dhe është botuar në vitin 2006⁸.

Shtrirja gjeografike e Peshkopatës së Arbnit nuk është njohur prej hartuesve të *“Ilirisë së Shenjtë”*. Sipas tyre Peshkopata e Arbnit ka pasur 4 manastire të urdhrit të Shën Benediktit: Shën Aleksandrin në Molandinë, Shën Aleksandrin në Prothas, në Belejë (sic), Shën Mërinë e Irrefandës dhe Shën Nikollën e Mirrathit⁹. Përcaktimi i shtrirjes gjeografike të Peshkopatës së Arbnit ka qenë i vështirë jo vetëm për hartuesit e *“Ilirisë së Shenjtë”*, por, siç e ka treguar A. Meksi, edhe për autorët e mëvonshëm, sepse të dhënat burimore janë të pakta¹⁰. Ato u përkasin kohëve të ndryshme dhe kanë mospërputhje për varësinë peshkopale të disa kishave dhe manastireve që u njihet vendndodhja.

⁴ *Relacione*, I, f.33.

⁵ *Relacione*, I-II.

⁶ *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia. Collegerunt et digesserunt D^r Ludovicus de Thallóczy, D^r Constantinus Jireček et D^r Emilianus Sufflay*, Volumen I (annos 344-1343 tabulamque geographicam continens), Vindobonae MCMXIII, Typis Adolphi Holzhausen, nr. 57, (më tej: *ADA, I* dhe *II*, Volumen II (annos 1344-1406 continens), Vindobonae, MCMXVIII, Typis Adolphi Holzhausen.

⁷ A. Meksi, *Peshkopata e Arbërit*, në: “Hylli i Dritës”, 1995, f.30-43.

⁸ F. Illia, *Famullia e Milotit*, Milot, 2006.

⁹ *Illyricum Sacrum*, 7, f. 192b-193a.

¹⁰ F. Illia, *Famullia e Milotit*, f. 91. “Djeçezi i Abënisë. Ky djeçezi duket se në fillim shtrihej në Elbasan e rrethet... Mons. Marin Bici e çon deri afër Kosovës. Sigurisht që ky djeçezi pat mbrritë ndër male të Lezhës e të Mirditës, vende që duket se i pat pas Djeçezi i Krujës”.

A. Meksi me të drejtë ka kritikuar ata autorë që Peshkopatën e Arbnit e kanë njësuar me Peshkopatën e Krujës. Para formimit të Peshkopatës së Arbnit, Kurbini ka qenë në Peshkopatën e Krujës. Kufiri natyror i saj në veri ka qenë lumi Mat. Ndërkaq ai ka gabuar me përfshirjen e krahinës së Kurbinit vetëm në Peshkopatën e Krujës¹¹. Në këtë përfundim duket se ai është ndikuar prej një letre të 18 gushtit të vitit 1457 që papa Kalisti III ia ka drejtuar “*abatit të manastirit të Shën Prenës (Sancta Veneranda) të Kurbinit, të Dioqezës së Krujës*”, të cilit papa i dha autoritet që të shqyrtonte gjendjen e manastirit të shën Mërisë së Ndërfandës dhe të vendoste për kërkesën e abatit dhe të kuvendit të këtij manastiri që t’u jepej kisha e shën Gjergjit për të shtuar të ardhurat e tyre¹². Ky dokument tërthorazi dëshmon për lidhjet midis kishave të Kurbinit dhe të Mirditës dhe se abati i Kurbinit po kryente rolin e peshkopit të Arbnit. Letra e papa Kalistit III është hartuar në një kohë kur në trojet shqiptare kishte mungesë klerikësh. Në vitin 1453 është shkruar se në Krujë “*nuk ka prift, as dialon katolik, që të ndihmojë gjatë meshës*” kapelanin napolitan Don Elinë¹³, që ishte dërguar në atë qytet bashkë me ushtarët e Alfonsit V. Papa Nikolla V i ka shkruar në vitin 1447 “*birit të dashur, abatit të manastirit të Shën Prenës (Sancta Veneranda) të Kurbinit të Dioqezës së Arbnit*”¹⁴. Pas pushtimit osman të Krujës në fund të vitit 1414, dokumentet kishtarë të shek. XV kanë kundërthënie për kishat e Kurbinit, ato herë janë përfshirë në Peshkopatën e Arbnit dhe herë në Peshkopatën e Krujës. Këto kundërthënie janë pasojë e organizimit të mëparshëm kishtar ortodoks dhe e përkeqësimit të veprimtarisë kishtarë. Në kohën e Skënderbeut Kruja ka qenë vendqëndrimi më i mirë për klerikët e lartë e të pakët të të gjithë kryepeshkopatës së Durrësit, trevat e së cilës ishin tashmë të çliruara prej Skënderbeut. Prandaj në dokumentet e kohës së Skënderbeut emri i peshkopit dhe i Peshkopatës së Krujës ka pasur përdorim e shtrirje më të gjerë se më parë.

Konfliktet midis Peshkopatës së Lezhës dhe Peshkopatës së Arbnit e kanë çuar A. Maksin në përfundimin e drejtë se, në mesin e shek. XII, prej peshkopatës së parë është shkëputur pjesa lindore e saj dhe për interesat e tyre fisnikët shqiptarë dhe kleri vendas krijuan Peshkopatën e

¹¹ A. Meksi, *vep. e përm.*, f.37-38.

¹² J. Радоњић, *Бурађ Каспруом*, nr. 146, f. 88-89.

¹³ *Po aty*, nr. 64, 74, 82; f.40, 42, 46.

¹⁴ *Archivio Segreto Vaticano*, Registro Laterano, vëll. 437, fl.24.

Arbnit. Peshkopatën e Arbnit e krijuan interesat ekonomike dhe politike të aristokracisë vendore shqiptare. Zhdukja apo tjetërsimi i kësaj aristokracie si rrjedhojë e pushtimit osman e zhveshi Peshkopatën e Arbnit nga mbështetja politike. Prandaj ajo u shua gradualisht dhe pjesë të saj iu bashkëngjitën peshkopatave të tjera.

Për njohjen e Peshkopatës së Arbnit prej Vatikanit, fisnikët e klerikët shqiptarë të kësaj treve shfrytëzuan ndarjet kishtare. Ata u shkëputën prej kryepeshkopatës ortodokse të Durrësit, nga varej peshkopata e Lezhës, dhe u konvertuan në katolike. Vatikani miratoi formimin e Peshkopatës së Arbnit dhe i dha kësaj peshkopate të re katolike një status të veçantë, që ajo të kishte lidhje të drejtpërdrejta me Selinë e Shenjtë¹⁵. Peshkopata e Arbnit u bë kështu shprehëse edhe e interesave politike të Vatikanit për përhapjen e katolicizmit në trevat ku vepronte kisha ortodokse.

Për konvertimin nga ortodoksë në katolike të klerit e të kishave të kryepeshkopatës së Durrësit, si edhe të vetë kësaj kryepeshkopate¹⁶, Peshkopata e Arbnit ka pasur rol parësor. Ajo ka qenë misionare e përhapjes së katolicizmit në trevat e kryepeshkopatës ortodokse të Durrësit. Prandaj, edhe sikur shtrirja fillestare e Peshkopatës së Arbnit të ketë qenë në trevën e Mirditës së sotme, pa kaluar shumë kohë kufijtë e saj u shtrinë gjithnjë e më shumë drejt jugut, duke zvogëluar kështu hapësirat e veprimtarisë së kryepeshkopatës ortodokse të Durrësit, kryesisht në pjesën veriore të saj, e cila ishte kufitare me Peshkopatën e Arbnit.

Emërtimi Peshkopata e Arbnit (*Episcopatus Arbanensis*) është marrë prej një makrotoponimie mesjetare (*Arbanum*) me shtrirje gjeografike të gjerë dhe që në jug përfshinte trevat rreth lumenjve Ishëm, Erzen e Shkumbin¹⁷. Në dokumentet e shek. XV është dalluar mirë se Arbni (*Arbanum, Albanum, Albano*) ishte një trevë e gjerë e Arbënisë (*Albania*). Arbni ishte poshtë Krujës (*l'Albano soto Croia*)¹⁸. Sundimtari i trevave përgjatë lumit Shkumbin, Gjergj

¹⁵ P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Tiranë, 2006, f.480.

¹⁶ O.J. Schmitt, *Arbëria Venedike*, f.134-140.

¹⁷ ADA, I, f.258, II, f.264; J. Радонић, *Бурађ Каструот*, f.305; K. Biçoku, *Viset etnike shqiptare në mesjetë dhe përhapja e emrit kombëtar Arbër (Arbëri, Albani)*, në: “Studime historike”, 1992, 1-4, Tiranë 1995, f.29; P. Xhufi, *Shqipëria gjatë shekujve V-XIV*, në: “Historia e Popullit Shqiptar”, vëll.I, Tiranë, 2002, f.208, 216, 221 etj; Po ai, *Dilemat e Arbërit*, f.3, 9,13, 19, 22-25, 52-53, 57, 75-88; O.J. Schmitt, *Arbëria Venedike*, f.52 etj.

¹⁸ J. Радонић, *Бурађ Каструот*, nr. 142, f. 87, 305.

Arianiti, ishte “zot në Arbën” (*dominus in Albano*), Andrea Topia “qëndronte në viset bregdetare të Arbënisë” (*in partibus maritimis Albanie resident*)¹⁹, kurse Skënderbeu “zot i Krujës dhe i Arbnit” (*dominus Croye et Arbani*)²⁰ në fillim të veprimtarisë antiosmane të tij.

Që me krijimin e saj, Peshkopata e Arbnit ka pasur shtrirje më të gjerë se krahina e Mirditës dhe, ç’është më e rëndësishme, si peshkopatë e lidhur drejtpërdrejt me Vatikanin ka pasur si mision të përhapë katolicizmin në Arbën (*Arbanum*), ku ushtronte ndikimin e vet arqipeshkvia ortodokse e Durrësit. Para konvertimit të peshkopatave të tjera të trevës së Arbnit nga ortodokse në katolike, Peshkopata e Arbnit ka përfshirë në gjirin e vet ata klerikë dhe ato kisha të kryepeshkopatës ortodokse të Durrësit që ishin konvertuar në katolikë. Ky proces ishte rrjedhojë e qëndrimin politik të aristokracisë vendase, që dëshmohet mirë, p.sh., në fund të shek. XII për familjen Skuraj të trevës së Tiranës së sotme dhe për sundimtarin e Arbnit, Dhimitrin, në fillim të shek. XIII²¹. Ky proces konvertimi në trevat e kryepeshkopatës së Durrësit ka qenë aq masiv, sa që edhe vetë kjo kryepeshkopatë u bë katolike²².

Shtrirja e Peshkopatës së Arbnit dhe e peshkopatave kufitare me të, sidomos Peshkopata e Lezhës dhe e Krujës, ka ndryshuar nga koha në kohë. Për këtë shkak dhe sidomos prej varfërisë së të dhënave burimore është i vështirë lokalizimi i Peshkopatës së Arbnit dhe i disa peshkopatave mesjetare që ishin në varësi të kryepeshkopatës së Durrësit.

Për shtrirjen e Peshkopatës së Arbnit dhe të peshkopatave kufitare me të, si e Shtjefnit etj., të dhënat burimore janë të pakta. Ato bëhen më të kuptueshme, duke njohur ndarjet krahinore, emrat e fshatrave që janë dhënë në dy regjistra kadastralë osmanë, në regjistrin e marsit të vitit 1467 dhe në regjistrin e vitit 1583. Emrat e fshatrave të krahinave dëshmojnë se gjatë një kohe më se njëshekullore, nga regjistrimi kadastral osman i vitit 1467 në atë të vitit 1583, janë ruajtur të njëjtat

¹⁹ *Po aty*, nr. 143, f. 87.

²⁰ *Po aty*, nr.40, f.24. Me një farë paqartësie e ka shprehur edhe I. Zamputi mendimin se emërtimi i Peshkopatës së Arbnit është prej emrit të trevës: “Ky relator (M. Skura) ... dioqezën Albanens e lidh me fjalën Alban, Albasan (Elbasan) ... Me sa ka thënë relatori tjetër më parë, peshkopi i Arbnit, Gjon Kolesi, ka më të ngjarë që titulli Albanens t’i përshtatet zonës më veriore malore e fushore, ku është zona fushore që populli e njeh për Arbni” (*Relacione*, II, f.469, shën. 13).

²¹ P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, f. 481.

²² ADA, I, 138; P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, f.481-483.

ndarje krahinore, sepse ato ishin krijime jorastësore dhe vinin nga thellësitë e shekujve.

Disa nga krahinat e Peshkopatës së Arbnit dhe të peshkopatave kufitare me të, në regjistrin kadastral osman të marsit të vitit 1467 janë shënuar me emrat e Matit, Urakës, Dhimitër Jonimës, Kurbinit, Krujës (Akçehisarit) e të Bendës²³. Në regjistrin kadastral osman të Sanxhakut të Ohrit të vitit 1583 janë dhënë këto ndarje krahinore: Kazaja e Matit (që përbëhej vetëm nga nahija e Matit) dhe kazaja e Krujës që përbëhej nga nahijet (krahinat) e Kurbinit, Pjetër Jonimës (Dhimitër Jonima e regjistrin të vitit 1467), Tomadhes, Malësisë, Rendishtës (Rrancia, Kruja) dhe të Karl Ilisë²⁴. Emërtimet krahinore Kurbin, Arbni, Rranci dhe Bendë janë ruajtur edhe në ditët tona²⁵.

Për temën e këtij shkrimi kanë interes që, duke njohur emrat e fshatrave që janë në regjistrat kadastralë osmanë të përmendur, të tregohet lokalizimi i krahinave mesjetare të Dhimitër Jonimës (Pjetër Jonimës), Kurbinit, Krujës, Bendës dhe të Misjes.

Emërtimi “*vilajeti i Dhimitër Jonimës*” gjendet për herë të parë në burimet osmane të viteve 30 të shek. XV²⁶. Në regjistrin kadastral osman të vitit 1467 janë përmendur 22 fshatra të krahinës së Dhimitër Jonimës²⁷, kurse në regjistrin kadastral të vitit 1583 e njëjta krahinë ka emrin Pjetër Jonima dhe i janë shënuar 25 fshatra dhe vende të braktisura (*mezra*)²⁸. Treva e Dhimitër (Pjetër) Jonimës,

²³ *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV - Burime osmane*, përgatitur për shtyp nga Selami Pulaha, Tiranë, 1968, f.326-373. (më tej: S. Pulaha, *Burime osmane*).

²⁴ *Турски Документи за историјата на македонскиот народ Опшерен пописен дефтер на од 1583 година*, том VIII книга 2, превод, редакција и коментар Д-р Александар Стојановски, Скопје, 2000, f.96-448 (më tej: A. Стојановски, *Охридскиот Санџак*).

²⁵ H. Goci, *Vështrim në toponomastikën e krahinës së Krujës*, në: “Kruja e Skënderbeut”, Tiranë, 1967, f.66-67.

²⁶ H. Inalcık, *Hicrî 835 tarihli Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanit*, Ankara, 1954, tîm. 335.

²⁷ S. Pulaha, *Burime osmane*, f.334-340, 364-366: Vishtuli, Solomoni, Kapruli, Bërzana, Gajpi (Gajushi), Bukati, Kurjasuti, Fiku, Matarisi, Skandani, Napëzi, Dushku, Dolaka, Skopëdhi (Shkopeti), Lurzi, Kolashi, Koshtanija, Lindiza, Zojmeni Zejmeniç, Shukalza, Shillazi dhe Pëdhana (Pllana).

²⁸ A. Стојановски, *Охридскиот Санџак*, f.270-292: Gajeti, Lopesi, Zyjmi (Zejmeni), Pezhana, Fiku, Tërkeshi, Shtëpani, Darda, Mantija, Kashtina, Brzana,

siç tregojnë emrat e fshatrave të regjistrave kadastralë osmanë të viteve 1467 dhe 1583, shtrihej në bregun verior të lumit Mat, nga Lezha deri në Rubik. Përfshirja e kësaj krahine në kazanë e Krujës dëshmon për lidhjet e ngushta historike të saj me trevën më jugore, me Kurbinin.

Në krahinën e Kurbinit janë regjistruar 11 fshatra më 1467²⁹, kurse në regjistrin kadastral të vitit 1583 janë shënuar 35 fshatra dhe vende të pabanuara (mezra)³⁰. Kurbini në shekuj ka pasur thuajse të njëjtën shtrirje si në ditët tona³¹.

Peshkopata e Krujës për herë të parë përmendet në vitin 879³² dhe si shtrirje kryesore (bërthamë) ka pasur trevën e këtij qyteti. Gjatë mesjetës qyteti i Krujës ishte përfshirë në krahinën e Rrancisë. Kjo krahinë shtrihej nga rrethinat veriore të qytetit të Krujës dhe në jug përfshinte edhe rrethinat e Tiranës së sotme. Kjo trevë vështrohet e kontrollohet mirë nga kështjella e Krujës. Kurse, prej këtu, pamja veriore, në drejtim të Kurbinit, ndërpritet prej maleve.

Në regjistrin kadastral të vitit 1467 Rrancia ka pasur 47 fshatra³³ (ku janë përfshirë edhe disa fshatra të Kurbinit), kurse në regjistrin kadastral të vitit 1583

Kukula, Shalësi, Kondani, Korvesuti, Mërqina, Lezha, Matresi, Sulimoni, Sheja, Skopeti, Kaprula, Lufa, Murtkina e Ishulli.

²⁹ S. Pulaha, *Burime osmane*, f.342-344: Dhulbinishti Delbinishtiç, Laçi, Breshati, Kaçula, Malibardë (Malibardhë), Selita, Gallata, Likapaji Lugapaçiç, Smaka, Kurbini dhe Madhëshi.

³⁰ A. Стојановски, *Охридскиот Санџак*, f.220-266: Pushneshi, Shillazi, Dolbineshi, Meljoti, Shefadaja, Laçi, Selita, Kurbini, Shkreta, Kuqani, Malibardë, Borishta, Davulla, Legopaçi, Madeshi, Esmaku, Zheja, Shkallza, Bredi, Gjonimi, Pesraku, Novaj, Mavrshiqi, Gallata, Marmuri, Shënmëria, Veliza, Skutini, Gazi, Lasta, Kaçulani, Kimiza, Leshi, Sultboriri e Kanizma. Për emrat e këtyre fshatrave shih edhe variantin e leximit të tyre prej osmanistëve shqiptarë dhe që janë botuar prej K. Biçokut, (K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f.71, shën. 14).

³¹ Kurbini i kohës sonë përfshin fshatrat: Shëmri, Zhejë, Gjonëm, Laç, Delbnisht, Shullaz, Malbardhë, Milot, Skuraj, Selitë, Gallatë, Daul-Lugopaç, Vinjollë, Shkretë, Mafsheq dhe Nuojë, (H. Goci, *vep. e përm.*, f. 66-67).

³² ADA, I, nr. 57.

³³ S. Pulaha, *Burime osmane*, f.344-346, 368-370: Mëshgradi, Mavroshaku, Nuaja, Çuzini (Cullini), Gjonimi (Gjonëmi), Birati, Domi, Luzi, Filakiti, Zhiji (Zheji), Skonili, Kuqani, Shkallaza (Shkalla), Viliza (Vilza), Birati, Rudhëshi (Radheshi), Briska (Priska), Shënshtjefni, Shëndëlli, Bujlla (Budulla), Buazi (Buzi), Pirazallsani (Hasani), Bilaniku (Bilaj), Makriku, Ozgurdishi (Zgërdheshi), Virjoni, Shëngjergji, Barkaneshi, Kurtseku (Kurçaj), Burini (Burani), Bogomeshi, Qinami, Kallmeti, Pinari, Patza (Tapiza), Krashkoza (Shkoza), Domi (Domja), Kashari, Bobotishi, Bobiqi, Bojtula, Kllakshi, Mazreku, Zeza, Skunili, Kuqani e Shkalla.

kjo krahinë ka 38 fshatra dhe vende të braktisura (mezra)³⁴. Edhe në fillim të shek. XVI Kruja dhe Rrancia (Rendezia) përmenden si një njësi kishtare³⁵. Emri i kësaj krahine është ruajtur edhe në ditët tona³⁶. Krahina mesjetare e Krujës (Rrancia), duke përfshirë edhe rrethinat e Tiranës së sotme, ka bërë që Marin Barleci të përdorte emërtimin Tiranë (Tirana e Vogël) edhe për fushën përballë qytetit të Krujës³⁷.

Benda është toponim i një krahine mesjetare që, tërthorazi, ndihmon për të njohur shtrirjen e peshkopëve së Krujës dhe, sidomos, shtrirjen e Peshkopatës së Shtjefnit, që ka mbetur ende e papërcaktuar mirë³⁸. Kjo peshkopatë del për herë të parë në vitin 879³⁹ dhe përmendet vazhdimisht në burimet historike mesjetare dhe të shekujve të parë të sundimit osman. Kjo peshkopatë shpesh del në emërtimin e dyfishtë “*Dhimitri, peshkop i Shtjefnit dhe i Bendës*” (*Demetrius episcopus Stephaniensis et Bedensis*)⁴⁰. Ky emërtim i dyfishtë është përdorur edhe për peshkopë të tjerë⁴¹. Kështu, p.sh., i njëjti peshkop (Andrea) përmendet si peshkop i Shtjefnit dhe pas një viti si peshkop i Bendës dhe

³⁴ A. Стојановски, *Охридскиот Санџак*, f.355- 395: Rodeshi, Barusha, Kali Mastreti, Kruja, Shugini, Vironi, Mondekli, Bogmeshi, Priska e Vogël, Shënkolli, Simopogani, Basi, Muzaku, Rana, Barkaneshi, Tomjani, Heni, Molla, Shtepani, Kelushi, Grebsa, Shëngjergj, Kurtiqi, Kakariqi, Penari, Zeza, Borana, Kurtesani, Golmasi, Kalimeti, Zgurdeshi, Lunkoçi, Bovilla, Zgafnara, Qenami, Luzi, Brari, Menjolli e Shelqet. Për emrat e këtyre fshatrave shih edhe variantin e leximit të tyre prej osmanistëve shqiptarë dhe që janë botuar prej K. Biçokut, (K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f.71, shën. 14).

³⁵ *Relacione*, I, f.141, 149, 151.

³⁶ Rrancia e sotme është ngushtuar shumë si shtrirje gjeografike dhe në të përfshihet Kruja, Brreti, Picrraga, Baraneshi, Kucaj, Zgërdheshi, Burani dhe Mukja, (H. Goci, *vep. e përm.*, f.67).

³⁷ M. Barletius, *Historia de Vita et Gestis Scanderbegi Epirotarum Principis Cum Privilegio* [Impressum Romae per B.V.] M. fl.XI^r, XVI^v, LXXI^r, LXXV^{r-v}, LXXVI^v, CLIII^v, CLV^v (përkth. shqip: M. Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, Tiranë, 1964, f.75, 93, 247, 258, 260, 263, 477, 479).

³⁸ F. Illia, *Famullia e Milotit*, f.90. “Djeçezi i Shtjefnit ... Jemi të mendimit se Djeçezi i Shtjefnit asht po ai i Lisit në krahinën e Matës”.

³⁹ *ADA*, I, nr.57.

⁴⁰ *Po aty*, II, Appendix, nr.21, f.292.

⁴¹ *Illyricum Sacrum*, 7, f.405b-406a, 406b-407a; *Hierarchia Chatholica*, I, f.441.

i Priskës⁴². Edhe në dokumentet e periudhës osmane del emërtimi i dyfishtë “*peshkop i Shtjefnit dhe i Bendës*”⁴³. Pra del e sigurt se Shtjefni dhe Benda kanë qenë një peshkopatë.

Dokumentet tregojnë se Peshkopata e Shtjefnit është “*përmbi Krujë*”⁴⁴ dhe si vendbanime të peshkopëve të Shtjefnit janë përmendur Priska, Burani, Killojka, Mamli etj.⁴⁵ Vendbanimi fillestar i peshkopëve, që i ka dhënë emrin peshkopatës, duhet të jetë kështjella e Shën Shtjefnit (*Sanctus Stephanus*), e cila është përmendur, në mesin e shekullit VI, prej Prokopit të Cezaresë si kështjellë e rindërtuar në Epirin e Ri prej perandorit bizantin Justinianit⁴⁶. Shtjefni (*Stephaniacum*) shfaqet si qendër peshkopale në shek. IX⁴⁷. Këtë emër sot e mban fshati Shtjefën në Mat. Në juglindje të tij, rreth një orë rrugë më këmbë është kështjella e Stelushit (Kalaja e Varoshit), e cila ruante grykat e Qafë-Murrës dhe të Gurit të Vashës dhe zotëronte kështu rrugën që lidhte Dibrën e Lurën me Matin e me bregdetin⁴⁸. Për lokalizimin e Peshkopatës së Shtjefnit në Mat e më gjerë do të flitet më poshtë.

Nëpërmjet toponimeve, që japin dy regjistrat osmanë të përmendur më parë, krahina e Bendës mesjetare lokalizohet në verilindje të Tiranës. Në regjistrin kadastral të vitit 1467 Benda ka 14 fshatra⁴⁹, kurse në

⁴² ADA, II, nr. 718, 747, Appendix, nr. 45, f.264. Benda dhe Priska janë konsideruar si dy peshkopata prej F. Illisë, (F. Illia, *Famullia e Milotit*, f.89-90).

⁴³ I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëllimi II (1593-1602), Tiranë, 1990, f.215, (më tej: *Dokumente të shekujve XVI-XVII*).

⁴⁴ *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, II, f.51.

⁴⁵ *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, I, f.344, III, f.33, *Relacione*, II, f.235, 339.

⁴⁶ *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Tiranë, 1965, f.440.

⁴⁷ ADA, I, 57, f.283.

⁴⁸ S. Anamali, *Kalaja e Varoshit në Mat-Stelushi, një hallkë e sistemit mbrojtës të Skënderbeut*, në: “Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, Tiranë, 1969, f. 249-253. Sipas S. Anamalit, emri i Stelushit rrjedh nga Stefaniaka.

⁴⁹ S. Pulaha, *Burime osmane*, f.346, 370-375: Pijac (Pjeç), Muniz, Bastar, Kulura, Bensh (Beshi), Buthonish, Bulshesh (Bulçesh), Shëngjin, Favrish (Favresh), Selitë, Lunzë (Linzë), Shënpal (Shupal), Mdosht [Dush] dhe Brusë.

regjistrin e fundit të shek. XVI ka 18 fshatra dhe vende të braktisura (mezra)⁵⁰. Benda si emërtim krahine vijon të përdoret edhe sot⁵¹.

Njohja e shtrirjes së Bendës si dhe përmendja e vendndodhjes së Peshkopatës së Shtjefnit “*përmbi Krujë*”, këto janë të dhëna të dorës së parë që mundësojnë lokalizimin e Peshkopatës së Shtjefnit. Gjatë mesjetës Peshkopata e Shtjefnit shtrihej në krahinën e Matit, në malësinë në lindje të Krujës e të Tiranës dhe në veri të Elbasanit. Peshkopi i fundit i saj, Nikollë Mekajshi, e ka pasur selinë e tij në fshatin Mamël⁵². Pas vdekjes së tij u emërua Gjon Kolesi⁵³, i cili mori titullin e peshkopit të Arbnit. Kjo ndikoi që emri i Peshkopatës së Shtjefnit të harrohet. Në fund të viteve 30 të shek. XVII emri i saj fillon e zëvendësohet me emrin e Peshkopatës së Lisit (*Diocesi Lisiense*) dhe që nga vitet 40 të atij shekulli Peshkopata e Shtjefnit nuk përmendet më⁵⁴. Lisi është pranë Stelushit dhe pranë fshatit Shtjefën të Matit⁵⁵. Gjatë mesjetës dhe periudhës osmane Lisi ka qenë qendra administrative e krahinës së Matit dhe vendbanimi më i madh i saj⁵⁶.

Jashtë Peshkopatës së Shtjefnit e të Bendës e në perëndim të saj shtrihet një trevë fushore dhe kodrinore shumë e madhe dhe e pasur. Në këtë trevë të gjerë, gjatë shekujve të mesjetës, ka qenë padyshim Peshkopata e Krujës, por jo e vetme pas krijimit e fuqizimit të Peshkopatës së Arbnit. E sigurt është që pjesa jugore e kësaj treve ka qenë e lidhur ngushtësisht me Peshkopatën e Krujës. Kurse kjo lidhje nuk mund të thuhet për pjesën veriore, duke përfshirë edhe Misjen mesjetare (Ishmin e sotëm)⁵⁷, e cila përmendet që në shek. XV⁵⁸. Pjesë e Misjes ka

⁵⁰ A. Стојановски, *Охридскиот Санџак*, f.328-349: Mner, Çezin, Selitë, Peç, Bastar, Kurtereq, Kurtesh, Bolshesh, Shëpal, Shëngjini i Vogël, Brosë, Florë, Farvesh, Begish, Dush Kamarda, Lunça, Shëngjergj dhe Qufë.

⁵¹ H. Goci, *vep. e përmb.*, f.67. Benda sot ka këto fshatra: Cudhi, Bruz, Rrazë, Mner, Bastar, Vilëz, Bulçesh, Besh, Dajt, Shëmri, Shëngjergj, dhe Qafmollë

⁵² *Relacione*, II, f.235.

⁵³ *Po aty*, II, f.339.

⁵⁴ *Po aty*, II, f.51, 245 etj.

⁵⁵ D.I. Kurti, *Trashëgimi iliro-arbërore*, Tiranë, 1999, f.304.

⁵⁶ S. Pulaha, *Burime osmane*, f.330; A. Стојановски, *Охридскиот Санџак*, f.133-148; D. Kurti, *Shënime etnografike në Mat*, Tiranë, 2004, f.44. Sipas regjistrave kadastralë osmanë të viteve 1467 dhe 1583, të përmendur në këtë shënim, Lisi ka qenë qendra tregtare e krahinës së Matit.

⁵⁷ Në regjistrin kadastral osman të Sanxhakut të Ohrit të vitit 1583 janë shënuar emrat e fshatrave dhe të vendbanimeve të braktisura të Misjes, që shtrihej

qenë edhe Kepi i Rodonit, ku gjatë shek. XIV-XV ka pasur të paktën 4 manastire: Shën Nastasia (*Sancta Anastasia*), Shën Kolli (*Sanctus Nicolaus*), Shën Mëria (*Sancta Maria*) dhe Shna Ndou (*Sanctus Antonius*)⁵⁹.

Kjo pjesë veriore e trevës së sipërpërmendur, sipas letrave e relacioneve të shek. XVI-XVII, përfshihej në Peshkopatën e Arbnit⁶⁰. Dëshmia më e rëndësishme për këtë është relacioni i vitit 1610 i kryepeshkopit të Tivarit, Marin Bicit. Gjatë udhëtimit të tij nëpër Rodon (Misje, Ishëm) M. Bici është shoqëruar nga peshkopi i Shtjefnit, Nikollë Mekajshi, që ishte i vetmi peshkop në të gjitha trevat e kryepeshkopatës së Durrësit dhe kujdesej për kishat e kësaj treve, si edhe nga peshkopi i Sapës, Nikollë Bardhi. Gjithashtu ai shoqërohej edhe nga klerikë të tjerë, që ishin në varësinë e peshkopit N. Mekajshi e që kujdeseshin për kishat e disa krahinave dhe që dhanë dëshmi për udhëtimin e M. Bicit, si Gjergj Bardhi (vikar i përgjithshëm në trevën e Rodonit), krutani Gjon Kolesi (ministër i Urdhrit të Observancës për Provincën e Arbënisë, Andrea Lopësi (famulltar i Krujës dhe vikar i Durrësit) etj⁶¹. Në relacionin e M. Bicit janë përmendur edhe emrat e disa klerikëve katolikë të trevës së Rodonit (Ishmit) që ai i ka takuar vetë. Në këtë relacion për Peshkopatën e Arbnit (Dicesi Albanense) është shkruar se kjo peshkopatë “*nuk është më, sikurse nuk janë shumë të tjera në Arbëni, ku kanë mbetur vetëm tri*

kryesisht në krahinën e sotme të Ishmit. Emrat e tyre do të jepen sipas leximit të botuesit të regjistrit (A. Стојановски, *Охридскиот Санџак*, f.558-587) dhe, kur ka ndryshime, në kllapa sipas leximit të Vexhi Buharasë: Monduh (Mondoh), Kelush (Kelos, Klos), Bizë, Korator (Kurator), Shpuran (Shporan), Bojtulë (Bujtulë), Zumanë, Mezak-Selita (Selitë-Muzhak), Shendolash (Shendylash), Koriq (Kuriq), Shamriq (Shakariq), Bubiç (Bubiç, Bubq), Lalesh (Lapesh), Laç, Konjas, Shëmëri ose Lalëz, Brez (Berez), Muzhil (Muzhin), Manëz, Savakosha (Savakoshta), Shendokën (Shëndkryq), Popotesh, Marqinet, Prespor (Paraspor). Përveç këtyre fshatrave, V. Buharaja ka dhënë prej regjistrit të vitit 1583 edhe këto toponime të Misjes: Kolovaç, Melkoc e Maraq, të vendosur midis fshatrave Laç e Konjas. Për leximin e V. Buharasë dhe lokalizimin e Misjes shih: K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f.185-218.

⁵⁸ K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f.185-218.

⁵⁹ ADA, I, 694, 788, II, 317; A. Dyselie, *Gjendja e Kepit të Rodonit në fillim të shek. XV sipas disa dokumenteve raguzane*, në: “Studime historike”, Tiranë, 1977, nr. 1, f.125.

⁶⁰ *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, I, f.357-358.

⁶¹ *Relacione*, I, f.217-220, 235.

peshkopata...e Sapës, e Lezhës dhe e Shtjefnit”⁶². Rrjedhimisht, prej klerikëve që e shoqëruan M. Bicin gjatë udhëtimit nëpër krahinën e Ishmit (Rodonit) apo që ai takoi në këtë trevë, askush nuk kishte interes që të mos tregonte të vërtetën për shtrirjen që ka pasur Peshkopata e Arbnit. Prandaj ato që janë shkruar për shtrirjen gjeografike të kësaj peshkopate, janë dëshmi kolektive e klerikëve vendorë që i njihnin më mirë se askush tjetër shtrirjet që kanë pasur peshkopatat e Kryepeshkopatës së Durrësit.

Në relacionin e tij M. Bici ka shkruar: “*Arritëm në lumin e Ishmit dhe atë mbrëmje Qullëzin (Chiuresi) në Dioqezën e Arbnit (Diocesi Albanense), ku në kishën e Shën Kollit shërbente D. Gjergj Bardhi, i quajtur maqedonasi dhe i caktuar vikar mbi priftërinjtë e Rodonit prej peshkopit të Shtjefnit...Prej Qullëzit shkua në fshatin e Muzhllit (Rusili) ku, në kishën e Shenjtëreshës shërbente D. Marku ... Në patentet ... shënohet se ai fshat është në Dioqezën e Arbnit (Diocesi Albanense) ... Nga këto fshatra që ishin përmbi kodrina u kthyem në anën e majtë nga fusha që i rri Krujës përballë...në fshatrat e Bilajt (ville di Belagni). Na doli përpara D. Dedë Vojo, nënprifti i Bilajt të poshtëm ... Ndër patentet edhe ai fshat thuhet se është në Dioqezën e Arbnit (Diocesi Albanense), e cila shtrihet për një pjesë të gjatë edhe në malet e Dukagjinit*”⁶³.

M. Bici ka shkruar për Dukagjinin: “*Ditën e fundit të korrikut u ktheva në Blinisht për të kaluar nëpër malet e Dukagjinit për të vizituar të krishterët e Serbisë ... Me ftesë të peshkopit të Sapës, shkua tek ai, sepse gjendet te shtegkalimi për në malet e Dukagjinit dhe se do të na shoqërojë për në Serbi ... Më 3 shtator qemë gati për udhëtim; kishte ardhë ... D. Nikollë Regji, prift i fshatit Ndërfandë të Dukagjinit ... Të nesërmen ... kalua në drejtim të fshatrave të Mirditës, që i lamë në anën e majtë të këtyre maleve dhe në mbrëmje arritëm në Bin, një prej fshatrave të Fanit, ku banonin krerët kryesorë të atyre banorëve ... Ato vende janë pjesërisht në Dioqezën e Arbnit (Diocesi Albanense) dhe pjesërisht në atë të Pultit ... Kërkova me pagesë të më jepnin disa djem të armatosur që të më shoqëronin deri në Kalis (Collesi) [fshat në jug të Kukësit - K. B.], që është fshati i fundit i atyre dukagjinasve në drejtim të Serbisë ... Kalua një ditë të mundimshme dhe të mërzitshme jo vetëm sepse rruga që e gjatë deri në Kalis, por sepse kalua nëpër male të*

⁶² *Po aty*, I, f.137.

⁶³ *Po aty*, I, f.133-139.

mëdha e vende të rrezikshme”⁶⁴. Kjo dëshmi e relacionit të M. Bicit ka vlerë parësore për të gjykuar për shtrirjen në shekuj që ka pasur Peshkopata e Arbnit.

Të dhënat e relacionit të M. Bicit për shtrirjen e Peshkopatës së Arbnit janë më të plota e tërësore se të dhënat e çdo burimi historik të njohur deri sot dhe ato, thuajse, përputhen me të dhënat fragmentare të dokumenteve mesjetare. Në këto dokumente janë përmendur si manastire benediktime të Peshkopatës së Arbnit: “*Sanctus Alexander in Collematia*” (Bregu i Matit), “*Sanctus Alexander de Molendino (del Mulino)*”, “*Sanctus Alexander de Monte*” (*Sanctus Alexander Major*), “*Sanctus Salvador de Rubico*” (*Sanctus Salvador in (supra) Petram*), “*Sanctus Salvador de Schiuli*”, “*Sancta Maria de Trefandana*” dhe “*Sancta Venera de Curbino*”. Si kishë e Peshkopatës së Arbnit, ndër të tjera, është përmendur “*Sancta Maria de Rodoni*”⁶⁵.

Letrat dhe relacionet e klerikëve katolikë për gjendjen kishtare në trojet shqiptare dëshmojnë se gjatë sundimit osman Peshkopata e Arbnit dhe shumë peshkopata të tjera të Kryepeshkopatës së Durrësit e kishin shuar veprimtarinë e tyre prej shumë kohësh. “*Dikur kanë qenë shumë peshkopë, por meqenëse [kishat] kanë qenë shkatërruar prej tiranisë së turqve, ka kohë, pothuaj 60 vjet, që është vetëm një peshkop për ato treva, sepse Selia Apostolike e ka gjykuar se ky është i mjaftueshëm për*

⁶⁴ *Po aty*, I, f.138-163. Për shtrirjen e Dukagjinit ka ndryshime midis rrëfimeve të klerikëve shqiptarë të gjysmës të shek. XVI, si edhe midis autorëve të tjerë të shek. XVII dhe të dhënave të dokumenteve të asaj kohe. Matjani Pjetër Budi, kur ishte peshkop i Sapës (Tejdrinit), ka shkruar në vitin 1621: “Popujt e krahinës së Dukagjinit... banojnë nëpër malësitë rreth Krujës dhe shtrihen deri pranë qytetit të Ohrit. Trevat e tyre janë: Bendera, Simi, Sumi, Iballa, Fandi i Vogël, Fandi i Madh, Mirdita” (*Po aty*, f.308-309). Hasiani Pjetër Mazreku, kur ishte në detyrën e kryepeshkopit të Tivarit, ka shkruar në vitin 1633: “Dioqezat e Tivarit, të Shkodrës, të Sapës e të Lezhës janë të përshkruara prej maleve të Dukagjinit” (*Po aty*, f.443). Në hartën e vitit 1689 të Xhakomo Kantelit nga Vinjola “Arbënia e Mirëfilltë ose e Epërme, e quajtur edhe Maqedonia Perëndimore” (*Albania Propria overo Superiore detta anche Macedonia Occidentale*) Dukagjin është emërtuar krahina e Matit. Nisur nga autorët e relacioneve të botuara prej tij, I. Zamputi ka shkruar se në fillim të shek. XVI Dukagjini shtrihej nga bregu i majtë i Drinit dhe arrinte deri në luginën e Matit. (*Po aty*, f.14).

⁶⁵ *ADA*, I, 93, 653; II, 228, A8D, A82; *Illyricum Sacrum*, 7, f.193a, 196b, 204b; *Relacione*, I, f. 133, 135, 137, 139, 159, 163; L. Tacchella, *Giorgio Castriota Scanderbeg e i romani pontefici nel secolo XV*, Verona, 1987, f.58, 61.

ato treva”⁶⁶, - ka shkruar në vitin 1625 peshkopi i Arbnit, krutani Gjon Kolesi. Ai kishte 10 vjet që ishte emëruar në krye të Peshkopatës së Arbnit dhe rrëfen se qendrat kishtarë më të rëndësishme të peshkopatës së tij ishin dy: “*Shën Prenë (Santa Venera, Sancta Veneranda) pranë qytetit të Krujës ... dhe Shenjti (il Santo), i quajtur kështu nga koka e shenjtit Aleksandër*”⁶⁷. Vendndodhjet e këtyre dy manastireve janë: Kurbini për të parën dhe Oroshi për të dytën.

Abacia e Shën Prenës e fshatit Kurbini të krahinës me të njëjtin emër ka qenë abaci e Peshkopatës së Arbnit. Këtë e dëshmon mirë një bulë e vitit 1447 e Papa Nikollës V: “*Birit të dashur, abatit të manastirit të Shën Prenës (Sancta Veneranda) të Kurbinit të dioqezës së Arbnit*”⁶⁸. Vendndodhja e manastirit është në faqen e malit midis fshatrave Gallatë dhe Skuraj⁶⁹. Nga manastiri shihet në drejtim të veriut, Mirdita dhe, nga perëndimi, fusha bregdetare e Kepi i Rodonit. Prandaj kjo abaci është bërë seli e Mark Skurës kur u emërua peshkop i Arbnit dhe më pas kryepeshkop i Durrësit. Kurbini ka qenë i përfshirë në Peshkopatën e Arbnit, po ashtu siç ishte edhe krahina e Pjetër (Dhimitër) Jonimës në veri të tij, që bashkë me Kurbinin ishin në të njëjtën kaza, në atë të Krujës.

Vdekja e Gjon Kolesit i la dorë të lirë peshkopit të Lezhës, raguzanit Benedikt Orsinit, që në vitin 1635 të përfshinte në gjirin e peshkopatës së tij atë pjesë të rëndësishme të Peshkopatës së Arbnit, që shtrihej në veri të lumit Mat⁷⁰. Që më parë ai e kishte marrë një pjesë të saj. Në vitet 20 të shek. XVII, B. Orsini ka shprehur mosmarrëveshjet e tij me peshkopin e Arbnit, Gj. Kolesin, duke e akuzuar atë se mban titullin e rremë “*Albanens, që duhet të jetë Albens, sepse nuk ka dioqezë të quajtur Albania*”. Gjithashtu ai ka treguar se Peshkopata e tij, që ka qenë në trevën fushore, kishte tashmë edhe pjesën malore të saj, Dibrin, që ishte pjesë e Dukagjinit, ku ishin kishat famulltare të Shën Mërisë në Shpërdhazë, Shën Gjergjit në Gjunal, Shën Mëhillit në Kashnjet, Shën

⁶⁶ *Relacione*, I, f.366-367.

⁶⁷ *Po aty*, I, f.366-369.

⁶⁸ Shih shënimin 12.

⁶⁹ *Albania Propria ouero Superiore detto anche Macedonia Occidentale descritta, con Disegni fatti sul luogo, da Giacomo Cantelli da Vignola ...*, Roma, 1689; F. Illia, *Famullia e Milotit*, f.77 .

⁷⁰ *Relacione*, II, f.245, 335.

Illias në Gazull dhe Shën Dhimitrit në Fand të Madh⁷¹. U rishfaq një konflikt i vjetër midis peshkopatave të Lezhës e të Arbnit, i cili dokumentohet që në kohën e Gjon Kastriotit, në vitin 1407.

Përballë një konflikti të tillë u ndodh krutani Mark Skura, peshkopi i ri i Arbnit, që u emërua pas vdekjes së Gjon Kolesit.

Në një letër të 19 prillit të vitit 1636 të Mark Skurës, drejtuar sekretarit të Kongregacionit të Propagandës Fide, ku flitet për konfliktin e tij me peshkopin e Lezhës, ai, pa dyshim, ka shkruar të vërtetën për kufijtë midis dy peshkopatave, sepse ata mund të verifikoheshin lehtësisht prej administratës së Vatikanit. Sipas letrës së M. Skurës *“Peshkopata e Arbnit (Diocese Albanense) ... arrin deri te fiku në shkëmbin pranë qytetit të Lezhës dhe prej andej tek të Shelbuemit (Santo Salvatore) e Veljes, nëpër Shën Gjergjin (San Giogio) e Gjunalit, nëpër Shën Mërinë (la Madonna) e Shpërdhazës dhe nëpër Shën Dhimitrin (San Demetrio) e Fandit të Madh”*⁷². Dibra dhe Mirdita ishin në Peshkopatën e Arbnit⁷³. Pas vitit 1636 letrat dhe relacionet e M. Skurës krijojnë pështjellim për shtrirjen e peshkopatave. Kështu, p.sh., kishat e mësipërme të Peshkopatës së Arbnit, që nga viti 1637 i ka përmendur si të përfshira në peshkopatat e Krujës dhe të Lisit, kurse emërtimin Peshkopata e Arbnit e ka përdorur për trevën e Elbasanit.

Për zgjidhjen e konfliktit për kufijtë e dy peshkopatave, Selia e Shenjtë ngarkoi kryepeshkopin e Tivarit, i cili i dha të drejtë Peshkopit të Arbnit⁷⁴. Por Peshkopi i Lezhës, raguzani Benedikt Orsini, nuk hoqi dorë prej pretendimeve të tij dhe arriti që Kongregacioni i Propagandës Fide të autorizonte kryepeshkopin e Raguzës për zgjidhjen e konfliktit midis dy peshkopatave. Për zgjidhjen e çështjes në vend, kryepeshkopi dërgoi si komisar raguzanin Gjergj Vuskoviqin. Ky mbajti anën e bashkëqytetarit të tij, Peshkopit të Lezhës.

Me gjithë ankesën e M. Skurës drejtuar Kongregacionit *“për arbitrimin e keq të komisarit Gjergj Vuskoviqit”*, ai u detyrua të bënte lëshime. Më 29 maj të vitit 1637 M. Skura i ka shkruar Kongregacionit të Propagandës Fide: *“Pasi po shoh kokëfortësinë e kërkesave të tij (Peshkopit të Lezhës - K. B.) unë po pranoj t'i jap famullitë e*

⁷¹ *Po aty*, II, f.389, 402-403.

⁷² *Po aty*, II, f.14-15.

⁷³ *Po aty*, II, f.68-69.

⁷⁴ *Po aty*, II, f.16-17, 20-25.

poshtëshënuara të Dioqezës së Krujës⁷⁵: *d.m.th. Shën Aleksandrin e Bojkanit, Shën Kollin (S. Nicolo) e Zejmenit, Shën Barbarën (Santa Barbara) e Pëdhanës. Dhe nga Dioqeza e Lisit unë po i lëshoj, me urdhër të atij Kongregacioni të Shenjtë, famullinë e Shën Palit të fshatit Pshtjesh e të Marajit, Shën Stefanin e Blinishtit (Blinishti i Mirditës - I. Z.), Shën Gjonin e Tumenistit (pranë Mashterkorës - I. Z.) dhe të gjithë fshatin e Mirditës së Epërme dhe atë të Dajçit përfshitas*⁷⁶. Kufijtë e Peshkopatës së Lezhës dhe kishat e saj të vitit 1638 janë dhënë të plota prej D. Farlatit⁷⁷. Lumi Mat ishte bërë kufiri jugor i kësaj peshkopate dhe Mirdita përfundimisht i ishte aneksuar asaj, duke u shkëputur prej Peshkopatës së Arbnit.

Ndërkohë, në fillim të vitit 1637 shfaqet Peshkopata e Lisit⁷⁸. Më shumë se një realitet historik, si krijesë e Vatikanit, Peshkopata e Lisit është një sajësë e M. Skurës për të rimarrë, tërësisht ose pjesërisht, ish-pjesën veriore të Peshkopatës së vërtetë të Arbnit. Po sajësë e tij është edhe Peshkopata e Arbnit e trevës së Elbasanit⁷⁹. Me pjesën veriore të

⁷⁵ Këto fshatra kanë qenë të Peshkopatës së Arbnit, emrin e së cilës, që nga viti 1637, M. Skura e ka zhvendosur në trevën e Elbasanit.

⁷⁶ *Relacione*, II, f.70-71.

⁷⁷ *Illyricum Sacrum*, 7, f.204a-b: Kishat që i përkasin dioqezës së Peshkopatës së Lezhës të përfshira brenda kufijve të sipërshkruar: Sanctus Nicolaus Alexii Cathedralis, Sanctus Georgius, & Sancta Maria de Castelo; item Sancta Maria ultra flumen Monasterium, Sanctus Joannes de Rennense, Sancta Veneranda de Ballareni, Sanctus Nicolaus de Cacarichi, sancta Euphemia de Calmeti, Sanctus Salvador de Velia, Sanctus Joannes de Merchigna, Sancti Cosma & Damianus de Manthia, Sanctus Blasius de Salumundi, Sanctus Demetrius de Darda, Sanctus Alexander de Bocchiano & Gaibbi, Sanctus Nicolaus de Soimeno, Sancta Barba de Pedana, Sanctus Georgius de Ficu, Sanctus Salvador de Rebico, Sanctus Georgius de Cucula, Sanctus Joannes de Bulgari, Sancta Maria de Nderfandina, & de Blexis, Sancta Veneranda, & Sanctus Marcus de Nchtella, Sanctus Alexander supra Montem Mirditarum Abbatia, Sancta Maria, & Sanctus Marcus de Fandi Vogli, San. Demetrius de Fandi Maze, Sanctus Paulus, & Sanctus Stephanus de Bliniscti, Sancta Maria de Sperdasa, Sanctus Georgius de Gianula, Sanctus Michaeli de Castagneti, Sancta Crux ad flumine Glomesichium, Sanctus Nicolaus de flumine Calami, Sancta Veneranda de Reja, Sancta Trinitas de Schiesa, & Sancta Maria Madalena de Barbatiorum”

⁷⁸ *Relacione*, II, f.51. Lokalizimi i saj në Mat (Po aty, f.510) e ka kufizuar shtrirjen reale të saj.

⁷⁹ *Po aty*, II, f.234-237, 338-343. Kjo ngatërresë e tij është pasqyruar edhe në punën e disa studiuesve, duke përfshirë edhe autorin e këtij artikulli. (K. Biçoku,

Peshkopatës së vërtetë të Arbnit dhe me trevat e Peshkopatës së Shtjefnit, M. Skura “krijoi” Peshkopatën e Lisit, emrin e së cilës D. Farlati nuk e ka shënuar në listën e peshkopatave të Kryepeshkopatës së Durrësit⁸⁰. Nga emrat e vendeve e të kishave të përfshira në të⁸¹, disa prej tyre, siç ka shkruar D. Farlati⁸², i kishin kaluar peshkopit të Lezhës.

M. Skura është thujse i vetmi që e përmend këtë peshkopatë. Frang Bardhi ka qenë nën ndikimin e këtij krijimi, kur ka shkruar: “*Të them të vërtetën imzot fra Mark Skura, peshkop i Arbnit, nuk do të mundet të mbajë kaq shumë peshkopata...d.m.th peshkopatën e tij të Arbnit dhe kryepeshkopatën e Durrësit me sufraganet e veta të Kunavisë, Bendës, Krujës e të Lisit*”⁸³.

Që nga kjo kohë, të dhënat e letrave dhe të relacioneve të hartuara prej M. Skurës gjatë një periudhe 14-vjeçare (1636-1650) japin përshtjellime për shtrirjen e peshkopatave të kryepeshkopatës së Durrësit. Ato fshatra e treva që në vitin 1636 ishin dhënë prej M. Skurës si të përfshira në Peshkopatën e Arbnit, pas një

Skënderbeu dhe Shqipëria në kohën e tij, Tiranë, 2005, f.22; Po ai, *Për Skënderbeun*, f. 108-110).

⁸⁰ *Illyricum Sacrum*, 7, f.XII-XIV.

⁸¹ “Kisha e Lisit është nën titullin dhe pajtimin e Shën Mërisë, pothuaj e rrënuar, pa të ardhura, pa peshkop, pa kanonikë, pa priftërinj e pa të krishterë... Peshkopata e Lisit ka kishë të ndryshme... Santo Demetrio di Cibaio...Sant’ Eufemia di Preeli...Santo Theodoro di Arbbe... Santo Alexandro në kodrën e Dukagjinit, e cila ka qenë abaci...Santa Zita, Santo Nicolo, Santa Maria & Santo Giorgio në tokën e Macukullit...Sancto Alexandro në tokën e Selitës...Sancto Salvatore di Scui po në Selitë në malet e Dukagjinit... Santo Nicolo di Beruci, Santa Maria di Lacigegi...Santo Biaggio, Santo Marco, Santa Veneranda di Chela [Thekëllës, I.Z.]... Santa Maria di Prega...Santo Elia di Baresa...Santa Barbara, Santa Veneranda & Santo Nicolo di Areni...Santa Maria di Seroi...Santo Quirito & Santo Andrea di Viemissti...Sancto Alexandro di Gurra...Santa Maria di Nderscena...Santo Giorgio di Recci...Santa Maria di Luria...Santo Demetrio & Santa Maria di Chidena...Santo Nicolo di Signa...Santo Salvatore di Bulaci...& Santo Demetrio, Santa Maria & Santo Nicolo & Santo Salvatore...Santo Giorgio di Muhuri...Santa Maria di Curtani...Santa Maria di Monte...Santo Nicolo di Gurasi...Santo Alexandro në malet e Mirditës, që është abaci...papa Pali ia ka lëshuar imzot Gjon Kolesit, peshkop i Arbnit...Santo Marco di Fanti vogël...Santa Maria di Pelana...Santa Maria d’Interfantina...Santo Demetrio & Santo Michaele di Tumenisti...Santo Stefani di Plijinishti, Sato Paolo di Paschessi dhe Santa Maria & Santo Nicolo di Mirediti” (*Relacione*, II, f.244-253, 330-335).

⁸² Shih shën. 72.

⁸³ *Relacione*, II, f.51.

viti, më 1637, ato përmenden si pjesë të Peshkopatës së Krujës dhe të Peshkopatës së Lisit. Peshkopata e Lisit shfaqet me këtë emër pikërisht në këto vite.

Duke humbur pjesën veriore (Mirditën e sotme e më gjerë) të Peshkopatës së Arbnit, që ishte më e rëndësishmja, sepse popullsia e saj ishte thuajse tërësisht katolike, M. Skura “rikrijon” me këtë emër një peshkopatë në trevën e Elbasanit. Emrin e këtij qyteti nga “*Albasani, Albassani, Elbasani*”⁸⁴ e bën në “*Albano*”⁸⁵. Kjo duhet të ketë qenë pjesë e Peshkopatës së Kunavisë, të cilën M. Skura e ka kufizuar në trevat e sotme të Peqinit, Rogozhinës e të Krujës.

Emri i Peshkopatës së Arbnit është ruajtur në kujtesën historike të anasve. Para vitit 1906 është quajtur Arbni fusha e Kurbinit dhe e Fushë-Krujës së sotme dhe ka përfshirë fshatrat: Gurëz, Gorre, Fushë-Kuqe, Mamurras, Thumanë, Burizanë, Derven, Gramëz, Sukth, Bilaj, Mallkuç, Mazhe, Bubq, Luz, Fushë-Krujë, Kroi i Fokës, Larushk, Nikël, Tapizë dhe Qerekë⁸⁶. Po sipas traditës popullore edhe krahina e Ishmit (Misja) emërtimin më të hershëm e ka pasur Arbni⁸⁷.

Gjatë mesjetës kjo fushë ka qenë moçalishte e me pyje, prandaj e pabanuar⁸⁸. Banorët e trevave kodrinore pranë kësaj fushe, sidomos ata të trevës kodrinore e malore në lindje të saj, kanë shfrytëzuar pasuritë natyrore të fushës, sidomos barin për dimërimin e bagëtive. Rrjedhimisht fushat bregdetare dhe malësitë kufitare me to ishin të lidhura ngushtësisht midis tyre.

Emri Arbni për fushën (Fusha e Arbnit) është gjurmë e tërthortë e emërtimit mesjetar Arbni të një treve shumë të gjerë. Ruajtja deri vonë e emrit Arbni për një trevë më të vogël ka të bëjë me shtrirjen e dikurshme të Peshkopatës së Arbnit.

II

Në mesin e shek. XII, kur u krijua Peshkopata e Arbnit, aristokracia shqiptare ishte e fuqizuar ekonomikisht dhe politikisht. Në këto rrethana fisnikët shqiptarë, nga radhët e të cilëve dilte kleri vendas, u përpoqën të krijonin formacionet e tyre shtetërore. Në këtë hulli është krijimi i Peshkopatës së Arbnit. Përfshirja në të e Mirditës nuk ishte e rastit, por lidhej me pozitën e rëndësishme gjeografike të saj.

⁸⁴ *Po aty*, I, f.138, 278, 300, 302, 308, 382.

⁸⁵ *Po aty*, II, f.234, 320, 338.

⁸⁶ H. Goci, *vep. e përm.*, f. 66-67.

⁸⁷ D. Luka, *Shënime mbi toponomastikën e krahinës së Krujës*, në: “Studime filologjike”, Tiranë, 1975, nr. 4, f. 99-100 dhe shën. 29.

⁸⁸ K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f.26-27, 193.

Shtrirja gjeografike e gjerë dhe përshkimi prej rrugësh tregtare, që lidhnin bregdetin me trojet lindore dhe trevat qendrore shqiptare me trevën veriore, kanë bërë që peshkopët, abatët dhe klerikë të tjerë të Peshkopatës së Arbnit të kishin peshë në jetën politike të vendit.

Studimet më të fundit kanë qartësuar se në trevat perëndimore shqiptare gjatë mesjetës, tregtia më e madhe me drithin (rrjedhimisht edhe me mallra të tjera të kohës, si kripa etj.) është bërë në Lezhë dhe në skelat detare e lumore pranë saj⁸⁹. Kjo dëshmon se rruga e karvaneve, që lidhte bregdetin pranë Lezhës (si Shufadanë etj.) me Prizrenin dhe trevat e tjera të Dardanisë (Kosovës e më gjerë), ka qenë shumë e rrahur dhe jetike për banorët e trevave perëndimore e lindore që tregtonin midis tyre. Prandaj përgjatë segmentit më të vështirë malor dhe zotërues të kësaj rruge, që ka kaluar nëpër Mirditë, kanë qenë ngritur manastire shumë të rëndësishme të Peshkopatës së Arbnit. Këto manastire kanë shërbyer edhe si stacione rrugore. Rruga Bregdet-Prizren ka ndjekur rrjedhjen e lumit Fan dhe të Fanit të Vogël dhe nga Kumlla e Fanit ka dalë në Lumë për të arritur në Prizren. Përgjatë saj burimet mesjetare përmendin këto manastire: Shën Aleksandrin e Bregut të Matit (*Sanctus Alexander de Collematia*), manastirin e Shelbuemit në Rubik (*Sanctus Salvator*), Shën Mërinë në Gëziq (*Sancta Maria di Trafandina*), Shën Palin (*Sanctus Paulus*) në Shënpal⁹⁰ dhe manastirin e Shën Llezhdrit në Orosh apo në Malin e Shenjtë (*Sanctus Alexander de Monte, Sanctus Alexander Maior*)⁹¹, që ka qenë qendra shpirtërore, politike dhe ekonomike e krahinës⁹². Përveç këtyre manastireve, gjatë mesjetës ka pasur në këtë trevë edhe shumë kisha⁹³.

Rruga shumë e rëndësishme që kalonte nëpër Peshkopatën e Arbnit dhe që lidhte bregdetin me Prizrenin, me të drejtë është emërtuar edhe si “*rruga tregtare nëpër tokën e Gjon Kastriotit*”⁹⁴. Ajo lindi dhe lidhi ngushtësisht midis tyre dy qytete, Lezhën dhe Prizrenin; po ashtu si rrugët e tjera tregtare, si Egnatia p.sh. që lindi dhe lidhi Durrësin me Ohrin, Selanikun me Manastirin. Nëpërmjet rrugës Lezhë (bregdet) - Prizren, - ka shkruar A. Dyselie, Gjon Kastrioti ka synuar të bëjë

⁸⁹ O.J. Schmitt, *Arbëria Venedike*, f.429-459.

⁹⁰ *Po aty*, f.182.

⁹¹ ADA, I, 93, 653, II, 228, A82; J. Радонић, *Бураћ Кастриот*, f.89; O.J. Schmitt, *Arbëria Venedike*, f.89, 131, 181-182.

⁹² O.J. Schmitt, *Arbëria Venedike*, f.182.

⁹³ *Illyricum Sacrum*, 7, f.204b. Shih shën. 77.

⁹⁴ J. Adami, *Rrugët dhe objektet arkeologjike në Shqipëri*, Tiranë, 1983, f.54, 56-57.

tregti transballkanike⁹⁵. Për lidhjen e trevave bregdetare me trevat lindore, pas Egnatias (Rrugës Mbretërore), ruga Lezhë-Prizren e më tutje ka qenë më e rëndësishmja në trojet e Arbënisë së Epërme e të Mesme. Prandaj Prizreni, vendkryqëzim i rrugëve kryesore ndërkrahinore, ka qenë qyteti më i rëndësishëm i Rrafshit të Dukagjinit e më gjerë.

Zotërimi i rrugës bregdet-Prizren ka qenë një faktor parësor për krijimin e Peshkopatës së Arbnit dhe për veprimtarinë ekonomike e politike të disa familjeve fisnike, si Kastriotët, Dukagjinët, Jonimët etj.

Në një dokument të viteve 20 të shek. XV Mirdita e sotme përmendet edhe si “*vendi i Dukagjinëve*”⁹⁶, që mund të lidhet me zotërimin e dikurshëm të kësaj treve prej familjes fisnike Dukagjini dhe me vëndorigjinën e saj. Emri i dytë familjar i Dukagjinëve, Perlati, ndoshta tregon prejardhjen e hershme të tyre nga fshati Perlat i Mirditës⁹⁷.

Në fund të vitit 1387 Dukagjinët janë bërë zotër të Lezhës dhe të rrugës tregtare që të çonte në trevat e Kosovës së sotme, siç dëshmohet prej një letre sllavisht të Lekë Dukagjinit drejtuar Republikës së Raguzës më 30 dhjetor të vitit 1387⁹⁸. Nga përmbajtja e letrës⁹⁹ del se, me përkrahjen e osmanëve, Dukagjinët kishin dëbuar zotëruesit e mëparshëm të rrugës tregtare që lidhte bregdetin me Prizrenin dhe, siç rrëfen M. Barleci, kishin në dorë edhe këtë qytet¹⁰⁰. Por prishja me osmanët bëri që Dukagjinët të largoheshin nga këto treva dhe, në vitin 1393, Lezhën ia dhanë Venedikut¹⁰¹. Zotërimet e tyre duket se u reduktuan në trevën e Tejdrintit (Zadrimës) dhe Dukagjinët u përpoqën të shtinin në dorë rrugën që,

⁹⁵ A. Ducellier, *Dalja në det e principatës së Kastriotëve prej fundit të shek. XIV deri në vdekjen e Skënderbeut*, në: “Konferenca e dytë e studimeve albanologjike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Tiranë, 12-18 janar 1968”, Tiranë, 1969, f.137.

⁹⁶ AAV, XI, f.54.

⁹⁷ *Po aty*, II, 694, 285.

⁹⁸ *Po aty*, II, 413; Gj. Shllaku, *Dokumenta historie*, në: “Hylli i Dritës”, Shkodër, 1940, nr. 1-2, f.83.

⁹⁹ “Prej Lekë Dukagjinit e vëllait tim Palit zotërve të përndritur të qytetit të Dubrovnikut. Po shkruaj, në emrin tim dhe të vëllait tim, që të udhëtoni lirish e pa asnjë frikë nëpër vendin tim. Për sa i përket doganës, të jetë sipas taksës legjitime që u paguhej zotërve të tjerë, që në këtë vend kanë qëndruar. Të mos kenë asnjë frikë, sepse ne jemi në paqe me turqit. Zoti ju gëzoftë”. Në shpinë të letrës: “Zotërve të përndritur të qytetit të Dubrovnikut, më 30 dhjetor 1387”.

¹⁰⁰ M. Barletius, *vep. e për.*, fl.XXVIv (përkth. shqip, f.119).

¹⁰¹ AAV, II, f.200.

përgjatë rrjedhjes së lumit Drin, lidhte bregdetin me Rrafshin e Dukagjinit. Synimi për kontrollin e qarkullimit nëpër këtë rrugë shpjegon përpjekjet e tyre të herëpashershme për marrjen e Dejës.

Po me përkrahjen osmane, rruga tregtare nga bregdeti e deri në Prizren, në mos tërësisht së paku pjesërisht, kaloi në zotërimin e Jonimëve, siç e dëshmon emërtimi Dhimitër Jonima i trevës nga Lezha në Rubik¹⁰². Deri në vitin 1409 Dhimitër Jonima përmendet si zotërues i qendrës tregtare e doganore të Shufadasë, në grykëderdhjen e lumit Mat¹⁰³. Edhe Jonimët nuk e mbajtën gjatë në zotërim rrugën tregtare që lidhte bregdetin me Prizrenin.

Në krahasim me Dukagjinët dhe Jonimët, që e zotëruan për pak vjet rrugën tregtare për në Prizren dhe, bashkë me të, Peshkopatën e Arbnit, Kastriotët janë zotëruesit e vërtetë e të lidhur ngushtësisht dhe për një kohë të gjatë me këtë rrugë, si edhe me Peshkopatën e Arbnit. Zotërimi i kësaj rruge dhe i trevave për qark duhet parë si shkak i mosmarrëveshjeve të njohura midis Skënderbeut dhe Dukagjinëve.

Gjon Kastrioti ka qenë sundimtar i rëndësishëm në fund të shek. XIV, siç e tregon edhe martesja e tij me Vojsavën rreth vitit 1390. Burimet e kësaj të dhëne dëshmojnë se i ati i saj ka qenë prej një dere “shumë fisnike dhe prijës i tribalëve” (sinonim i bullgarëve)¹⁰⁴. Sipas një hipoteze të fundit, pa mbështetje burimore, Vojsava është konsideruar vajzë e familjes së njohur aristokrate Brankoviçi, që në atë kohë sundonte trevën e Kosovës së sotme e të Maqedonisë dhe Shkupin e kishte kryeqendër të saj¹⁰⁵. Martesa me Vojsavën, vajzën e prijësit të bullgarëve, dëshmon se në atë kohë Gjoni ka qenë sundimtar i fuqishëm dhe se në zotërim të familjes së tij ka pasur treva të gjera dhe qytete. Vojsavën, që kishte jetuar në qytet, prindërit nuk mund ta martonin me një sundimtar të rëndomtë që nuk zotëronte qytete dhe që jetonte në një fshat të humbur të

¹⁰² H. Inalcık, *vep. e përm.*, tim. 335; S. Pulaha, *Burime osmane*, f.334-340, 364-366.

¹⁰³ AAV, III, f.210, 211, 380; V, f.261.

¹⁰⁴ M. Barletius, *vep. e përm.*, fl.IV, XCv (përkth. shqip, f.50, 302); Charles Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*, Berlin, 1873, f.295, 301.

¹⁰⁵ B. Petrovski, *Vojsava Tribalda*, në: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu (1405-1468)”. (Materiale nga tubimi shkencor, me rastin e 600-vjetorit të lindjes së tij, mbajtur në Shkup më 25 dhe 26 nëntor 2005), Shkup, 2006, f.67-77.

Peshkopisë¹⁰⁶. Edhe sikur të ishte kështu, sipas traditës së martesave të familjeve sundimtare, nga zotërimet e prindërve të saj Vojsavës i janë dhënë si prikë treva, që kanë pasur edhe ndonjë qytet për të jetuar familjarisht. Është e dokumentuar se Prizreni, vendkryqëzim rrugësh ndërkrahinore dhe qendër e një treve të gjerë fushore e malore¹⁰⁷, ka qenë në zotërimin e Gjon Kastriotit¹⁰⁸. Prizreni i fundit të shek. XIV dhe i fillimit të shek. XV ofron të dhëna të mjaftueshme për ta konsideruar atë kryeqendër të shtetit të Gjon Kastriotit, vendbanim të familjes Kastrioti dhe vendlindje e Heroit tonë Kombëtar dhe e motrave e vëllezërve të tij.

Jeta qytetare e pajisi Skënderbeun me kulturë të gjerë humaniste dhe e bëri atë njohës të shkëlqyeshëm të disa gjuhëve të huaja. Skënderbeu “*e kupton dhe e flet mirë italishten, si çdo njëri nga ne*”, kështu kanë shkruar në dhjetor të vitit 1466 dy ambasadorë milanezë që po e shoqëronin Skënderbeun gjatë qëndrimit në Romë¹⁰⁹.

Duke zotëruar Prizrenin dhe trevën shumë të gjerë të tij, Gjon Kastrioti e kishte të domosdoshme daljen në bregdet për të zotëruar rrugën që lidhte Prizrenin me bregdetin, tregtinë që bëhej nëpërmjet saj, si edhe furnizimin e nënshtetasve të tij me mallra jetikë, si kripa etj. Prandaj dalja në bregdet e Gjon Kastriotit është e lidhur ngushtësisht me zotërimin e Peshkopatës së Arbnit prej tij. Për këtë ai ka shfrytëzuar konfliktin e Peshkopatës së Arbnit me Peshkopatën e Lezhës.

Sipas një dokumenti të fillimit të vitit 1407¹¹⁰, peshkopi i Lezhës kishte futur në zotërimin e tij 12 kisha të Peshkopatës së Arbnit. Kjo do të ketë ngjarë në fund të shek. XIV, kur qyteti i Lezhës kishte kaluar në duart e Dukagjinëve. Për t’i siguruar pushtetit të tyre mbështetje shoqërore (sidomos mbështetjen e klerit) në qytetin e Lezhës e në trevën e saj, Dukagjinët kanë përkrahur ambiciet e peshkopit të Lezhës për të zotëruar 12 kishat e Peshkopatës së Arbnit.

¹⁰⁶ K. Frashëri, *Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, Jeta dhe vepra (1405-1468)*, Tiranë, 2002 (2003), f. 61-68.

¹⁰⁷ K. Viçoku, *Shtirirja lindore e zotërimeve të Kastriotëve*, në: “Skënderbeu dhe Evropa” (Përmbledhje kumtesash), Tiranë, 2006, f.63-64.

¹⁰⁸ J. Радоњић, *Бурађ Кастриум*, nr.2, f.2.

¹⁰⁹ O.J. Schmitt, *Skanderbegs letzte Jahre-West-Östliches Wechselspiel von Diplomatie und Krieg im Zeitalter der osmanischen Eroberung Albaniens (1464-1468)*, në: “Südost-Forschungen” ... Band 63/64, 2004/2005, München, f.122.

¹¹⁰ AAV, V, f.21-22.

Peshkopë dhe klerikë të tjerë të rëndësishëm të Peshkopatës së Arbnit kanë qenë bashkëpunëtorë të ngushtë të Gjon Kastriotit dhe të Skënderbeut. Ndër ta do të veçonim abatin Pjetër, kushëri i Kastriotëve, dhe peshkopin Andrea. Në korrik të vitit 1439 abati Pjetër qe dërguar prej Skënderbeut dhe nënës së tij në Raguzë për të përmbyllur detyrimet financiare që tregtarët raguzanë të drithit kishin ndaj Gjon Kastriotit, i cili kishte vdekur¹¹¹. Në dhjetor të vitit 1447 abati Pjetër qe dërguar si përfaqësues i Skënderbeut pranë Mbretit të Napolit, Alfonsit V¹¹². Kurse peshkopi Andrea ka qenë në krah të Skënderbeut gjatë nënshkrimit, më 4 tetor të vitit 1448, të traktatit të paqes midis tij dhe Venedikut¹¹³.

Në dokumentin e vitit 1407 Gjon Kastrioti është cilësuar prej Senatit të Venedikut si “*zot shumë i fuqishëm në trevat e Arbënisë*”. Pushteti dhe ndikimi i tij në mjedisin shqiptar të kohës janë vlerësuar si shumë të rëndësishme për interesat e Venedikut. Në vitin 1408 ai u bë garant i paqes që u nënshkrua në rrethinat e Durrësit midis Venedikut dhe Balshajve¹¹⁴. Si zotëruese e Lezhës, Republika e Venedikut normalisht duhej të përkrahte interesat e peshkopit të këtij qyteti për zotërimin e 12 kishave të Peshkopatës së Arbnit. Por nuk ndodhi kështu, sepse lidhjet me Gjon Kastriotin ishin shumë të rëndësishme për Republikën e Venedikut. Pa e përmendur emrin e Gjon Kastriotit, Senati i Republikës i shkroi Papa Grigorit XII që 12 kishat që ishin marrë prej peshkopit të Lezhës, duhej t’i riktheheshin Peshkopatës së Arbnit se ndryshe pakënaqësia e banorëve të atyre anëve do të shkaktonte trazira.

Angazhimi i Gjon Kastriotit për 12 kishat e Peshkopatës së Arbnit ishte lidhur ngushtësisht me interesa vetjakë. Ato duhet të jenë kisha të krahinës së emërtuar më vonë “*Dhimitër Jonima*”, që kishte dalje në det, sepse në vitet 30 të shek. XV Skënderbeu ka pasur aty një timar të madh me 9 fshatra së paku¹¹⁵. Po nga dokumentet osmane të asaj kohe del se Gjon Kastrioti ka zotëruar krahinën e Misjes (Ishmit) dhe ka qëndruar aty për shumë kohë. Pas shtypjes së kryengritjes antiosmane të Gjon Kastriotit, i biri i tij, Skënderbeu, si kuadër osman u ka kërkuar autoriteteve të Perandorisë Osmane që Misjen ta zotëronte si zeamet¹¹⁶. Siç është treguar më parë, Misja ishte pjesë e Peshkopatës së Arbnit.

¹¹¹ L. Malltezi, *Një dokument i ri*, f.61-64.

¹¹² J. Радонић, *Бурађ Кастриот*, nr. 16, f.9.

¹¹³ *Po aty*, nr.22, f.15.

¹¹⁴ AAV, V, f.141.

¹¹⁵ H. Inalcık, *vep. e për.*, tim. 335; K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f.176.

¹¹⁶ S. Pulaha, *Burime osmane*, f.322.

Krahas Peshkopatës së Arbnit, Kastriotët kanë qenë të lidhur ngushtësisht edhe me Peshkopatën e Shtjefnit. Në zotërim të Gjon Kastriotit ka qenë treva e Matit¹¹⁷, që ishte pjesa më e rëndësishme e Peshkopatës së Shtjefnit. Kufiri lindor i kësaj peshkopate ka qenë Drini i Zi, siç e ka treguar Mark Skura për pasardhësen e saj, Peshkopatën e Lisit¹¹⁸. Edhe në një letër të vitit 1459 të Papa Piut II¹¹⁹ nënkuptohet se Drini i Zi mund të konsiderohet si kufiri ndarës i veprimtarisë kishtarë të dy peshkopatave katolike (të Arbnit e të Shtjefnit) me trevat në lindje të tyre dhe që ishin kryesisht nën ndikimin e kishës ortodokse sllave. Në trevat e këtyre dy peshkopatave katolike nuk ka pasur ndonjë qendër të mirëfilltë qytetare, ku mund të jetonte familja e Gjon Kastriotit dhe që mund të shërbente si qendër administrative e shtetit të tij.

Përveç trevave perëndimore, ku ushtronin veprimtarinë e tyre peshkopatat katolike të Arbnit e të Shtjefnit, Gjon Kastrioti ka qenë shumë i lidhur edhe me trevat në lindje të tyre dhe që ishin nën ndikimin e kishës ortodokse sllave. Dokumentet mesjetare dëshmojnë se Gjon Kastrioti ka zotëruar Prizrenin¹²⁰, qendër e rëndësishme e kishës ortodokse sllave. Në të ka qenë vendosur administrata qendrore e shtetit të Gjon Kastriotit, prandaj kancelaria e tij ka përdorur kryesisht sllavishten si gjuhë komunikimi me vendet e tjera. Krahas pjesës veriore të maleve të Sharrit, tërthorazi dëshmohet se nën pushtetin e Gjon Kastriotit ka qenë edhe pjesa jugore e tij. Në vitin 1426 ai i dhuroi manastirit të Hilandarit dy fshatra të Rekës, Rostushë (Radostushë) dhe Trebishtë¹²¹, që janë pranë manastirit Bigorski dhe 25 km në lindje të qytetit të Dibrës¹²². Dhurimi dëshmon se në zotërim të Gjon Kastriotit ka qenë lugina malore strategjike e Radikës. Këtu ishte një vendkryqëzim rrugësh malore që vinin nga lugina e Vardarit, Prizreni dhe Kërçova për t'u lidhur me rrugën e Drinit të Zi¹²³ dhe për të vijuar nëpër Matin e Kastriotëve drejt bregdetit, i cili u kontrollua prej tyre së paku në fund të viteve 30 të shek. XV, kur Skënderbeu u bë subash i vilajetit të

¹¹⁷ M. Barleci, *vep. për.*, fl.11r, Vv (f.50, 59); E. Polito, *I Musachi di Berat*, Lecce, 1966, f.56-57, 128-129, 261, 288.

¹¹⁸ Shih shënimin 76.

¹¹⁹ J. Радонић, *Бурађ Каструом*, f.112.

¹²⁰ *Po aty*, f. 2.

¹²¹ *Po aty*, f. 2.

¹²² M. Lutfiu, *Tërbeshët - etnologjia dhe manastiri i Shën Gjon Mbigurit dhe pjesëmarrja shqiptare në të*, në: “Dibra dhe etnokultura e saj”, Simpozium shkencor (19-21 nëntor 1993), vëll. I, Dibër, 1995, f.111.

¹²³ I. Каса, *Rruga e madhe transversale e Luginës së Drinit të Zi – degë e rëndësishme e “Via Egnatia”*, në: “Dibra dhe etnokultura...”, vëll. I, f.75, 80.

Krujës. Zotërimi prej Kastriotëve i pjesës perëndimore të kësaj rruge, lejon të mendosh se ata kanë kontrolluar edhe pjesën e rrugës që kalonte nëpër luginën e Vardarit.

Kryengritja e përgjithshme antiosmane e nëntorit të vitit 1443, e drejtuar prej Skënderbeut, çliroi të gjitha trevat e Peshkopatës së Arbnit, ato të Kryepeshkopatës së Durrësit dhe shumë treva të tjera shqiptare. Për ruajtjen e konsolidimin e kësaj fitoreje historike Skënderbeu dhe fisnikët e tjerë shqiptarë, më 2 mars të vitit 1444, mbajtën në Lezhë një Kuvend historik, ku krijuan Besëlidhjen Shqiptare, që ishte bashkimi i parë kombëtar politik dhe ushtarak i shqiptarëve.

Ky bashkim politik i vendit përfshiu edhe klerikët shqiptarë. Këta i shuan grindjet midis tyre për zotërimin e kishave, siç kishte ndodhur midis Peshkopatës së Arbnit dhe Peshkopatës së Lezhës në kohën e Gjon Kastriotit, i cili kishte përkrahur të parën. Edhe për këtë qëllim Skënderbeu e mbajti kuvendin e bashkimit kombëtar në kishën katedrale të Shën Kollit të Lezhës.

Peshkopi Andrea i Lezhës gjatë viteve 50-60 të shek XV ka qenë bashkëpunëtor i Skënderbeut dhe përkrahës i politikës së tij. Ky peshkop dhe peshkopi Nikolla i Pultit u shkëputën nga sundimtarët separatistë të trevave të peshkopatave të Lezhës e të Pultit ose kufitare me to, që kanë qenë Dukagjinët, dhe u bënë përkrahës të politikës centralizuese të Skënderbeut. Gjatë viteve 50 të shek. XV Dukagjinët u afruan me osmanët dhe hynë në mosmarrëveshje të thella me Skënderbeun. Përballë një situatë të tillë, peshkopi Andrea i Lezhës dhe peshkopi i Pultit, Nikolla, u radhitën në krah të Heroit tonë Kombëtar, zbatuan porosinë e papa Kalistit III për shkrishterimin e Dukagjinëve dhe, më pas, ndikuan për largimin e tyre prej osmanëve dhe për rivendosjen e lidhjeve të Dukagjinëve me Skënderbeun¹²⁴.

Në mesin e viteve 50 të shek. XV, kur kisha e Shën Kollit të Lezhës u dëmtua rëndë dhe u shkatërrua, Papa Kalisti III miratoi kërkesën e Skënderbeut që të lëshonte indulgjenca për ata që do të ndihmonin për rindërtimin e kishës së Shën Kollit të Lezhës¹²⁵, që u bë më pas edhe vendvarrim i tij.

Lezha gjatë kohës së Skënderbeut u lidh ngushtësisht me Heroin tonë Kombëtar, aq sa ajo dhe rrethinat e saj mund të thuhet se zotëroheshin prej tij edhe pse ato juridikisht ishin zotërim venecian. Gjatë konfliktit ushtarak me

¹²⁴ J. Радоњић, *Бугарј Каструот*, nr.138.

¹²⁵ Theiner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium historiam illustrantia maximam partem nondum edita*, Romae, 1863, vëll. I, f.425; L. Tacchella, *Giorgio Castriota Skanderbeg e i Romani Pontifici nel secolo XV*, Verona, 1987, f. 24-25.

Venedikun ushtria e Skënderbeut ka kaluar pa asnjë pengesë nëpër trevën e Lezhës dhe, me përjashtim të këtij qyteti, ai ka sulmuar qytetet e tjera shqiptare që ishin në zotërimin venecian, si Durrësin, Tivarin, Shkodrën, Drishtin, Dejëen etj. Gjithashtu pranë Lezhës ka qenë kampi i Heroit tonë Kombëtar, kur u nënshkrua traktati i paqes midis tij dhe përfaqësuesve të Venedikut më 1448. Shumica e letrave të Skënderbeut, që njihen deri sot, janë shkruar në Lezhë. Kjo tregon se ai ka banuar kryesisht në këtë qytet për të ushtruar veprimtarinë e tij politike dhe ekonomike.

Peshkopata e Lezhës ka qenë e lidhur ngushtësisht me Skënderbeun, prandaj peshkopi Andrea u vu në krah të Pal Engjëllit në kuvendin kishtar që u mbajt më 8 nëntor të vitit 1462 në kishën e Shën Trinisë të Matit¹²⁶.

Në këtë kuvend filloi shkrimi i gjuhës shqipe dhe procesi i shqiptarizimit të Kishës Katolike në trojet shqiptare. Ky kuvend është ngjarje e rëndësishme historike, sepse parapriu procesin e reformimit të Kishës Katolike në Shqipëri.

Në aktet e këtij kuvendi është shkruar: *“Nën të ndriturin zotin Skënderbe, zot i Arbënisë, dinjiteti kishtar gëzon të gjithë lirinë dhe mbrojtjen...Klerikëve u lejohet të mbajnë armë, të plagosin dhe të vrasin”*¹²⁷. Prandaj klerikët shqiptarë kanë qenë pjesëmarrës aktivë në luftën antiosmane të Skënderbeut. Ata kanë mbështetur pa lëkundje politikën e brendshme të tij për krijimin e shtetit të bashkuar shqiptar dhe kanë pasur rol parësor në trojet e këtij shteti për vënien në jetë të vendimeve e të urdhërësive të Skënderbeut si kryetar sovran i shtetit shqiptar.

Krahas klerikëve të mësipërm dhe atyre të Peshkopatës së Arbnit, si abati Pjetër e peshkopi Andrea¹²⁸ (peshkopatë kjo e lidhur me Kastriotët që në kohën e Gjonit), Heroi ynë Kombëtar pati si bashkëpunëtorë e ambasadorë të tij edhe klerikë të tjerë të shquar të trevave të largëta, që nuk u përfshinë në shtetin e bashkuar shqiptar. Ndër ta duhet veçuar Gjergj Pelini, abat i manastirit të Shën Mërisë së Rotecit pranë Tivarit, që ishte në zotërimin venecian. Ky abat për gati 20 vjet ka qenë bashkëpunëtor i ngushtë i Heroit tonë Kombëtar dhe ambasadori i tij më jetëgjatë në këtë detyrë. Vendin e Gjergj Pelinit, pas vdekjes, e zuri

¹²⁶ N. Jorga, *Notes*, IV, f. 194-198. Për jetën dhe veprimtarinë e Pal Engjëllit shih: O.J. Schmitt, *Paul Angelus, Erzbischof von Durazzo, und seine Bedeutung für den Türkenkampf Skanderbegs*, në: “Thesaurismata”, 30 (2000), Benetia, 2000, f.127-161; Po ai, *Skënderbeu si Aleksandër i ri. Përvetësimi i traditës së antikitetit në Arbërinë e mesjetës së vonë*, në: “Hylli i Dritës”, nr. 2 (253), Shkodër, 2007, f.36-56.

¹²⁷ J. Радонић, *Бурађ Кастриот*, nr.241.

¹²⁸ Shih shën. 2 dhe 110-112.

denjësisht Pal Engjëlli, kryepeshkop i Durrësit dhe hartues i Formulës së Pagëzimit¹²⁹.

S u m m a r y

THE BISHOPRIC OF ARBNI AND THE KASTRIOTS

The definition of the regional (geographical) extends of the Bishopric of Arbni (*Episcopatus Arbanensis*) is an important issue as much for the history of the church organisation as for the political history of the Albanian lands during the middle ages. According to a document of the beginning of the 15th century, the Bishopric of Arbni extended in the domination of Gjon Kastrioti. Bishops and abbots of the Bishopric of Arbni get mentioned in the documents of the time as missionaries of Gjon Kastrioti and later of Scanderbeg in other places.

During the middle of 12th century it was established the Bishopric of Arbni, the Albanian aristocracy was consolidated economically and politically. Under these circumstances the Albanian noblemen part of which was also the clergy tried to constitute the state structures. In this context the creation of the Bishopric of Arbni which included Mirdita, Kurbini and Misja (nowadays region of Ishmi). The inclusion of Mirdita is not chanceful but it is related to its important geographical location. The wide geographical extend and the traverse by trading routes that connected the coast with eastern territories and central parts of Albania with the northern ones has made possible for the bishops, abbots and other clerics of the Bishopric of Arbni to have had an important role in the political life of the country.

The possession of costal road to Prizren has been primary factor for the creation of the Bishopric of Arbni and for the economical and political activities of several noble families such as the Kastriots, the Dukagjins, the Jonims etc.

In comparison with the Dukagjins and Jonims who possessed it for only a few years the traders rout to Prizren and along it the Bishopric of Arbni, the Kastriots are real possessors and closely related for a long time with this rout as well as with the Bishopric of Arbni. The possession of this road and its surrounding areas need to be regarded as the reason for the acknowledged disagreements between Scanderbeg and the Dukagjins.

¹²⁹ J. Радонић, *Ђурађ Кастриот*, nr.24, 37, 51, 137, 139, 141, 148, 151, 248, 301, 204, 248, 269, 301 etj.